



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1044 Prot.

Patos, më 19 / 05 / 2026



PROJEKTVENDIM
Nr. 26, datë 19/05/2026

**PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 04, DATË 30.01.2026 “PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË GRANTIT ME BAZË PERFORMANCE E
FITUAR PËR VITIN 2025 DHE SHTIM BUXHETI PËR VITIN 2026”**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kreut VII-të të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 82, datë 17/12/2025 “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin e Bashkisë Patos për vitin 2026”,

KËRKON:

- Të miratojë saktësimin e emërimit përfundimtar të projektit “Krijimi i parkut rekreativ në lagjen e Re”.
- Të miratojë ndryshimin e shkronjës b, pika 2, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 04, datë 30.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026” duke transferuar fondin prej 3,681,835 lekë nga objekti “*Studim, projektim dhe hartim i PDV-ve*”, në objektin “*Rikonstruksioni i rrugës Manxharaj, Gjy노qarë*”, brenda programit “Zhvillimi Ekonomik dhe Rural”.

Bashkëlidhur relacioni shpjegues.

Drejtuesi i Programit

Zhvillimi Ekonomik dhe Rural

Boreta Murati

Dr. Mbrojtjes sociale, Arsmi

Kulturës dhe Sportit

Mitjon Nikolla

Dr. Finance

Mimoza Shtëmbari

Zy/Kryetar

Ina Sauli

Juristi

Joana Sherifi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1644 / Prot.
1

Patos, më 19 / 05 /2026

RELACION

**PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 04, DATË 30.01.2026 “PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË GRANTIT ME BAZË PERFORMANCE E
FITUAR PËR VITIN 2025 DHE SHTIM BUXHETI PËR VITIN 2026”**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kreut VII-të të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 82, datë 17/12/2025 “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin e bashkisë Patos për vitin 2026”,

Me vendimin e këshillit nr. 04, datë 30.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026”, është miratuar shtesa e fondit për zbatimin e projektit për “Krijimin e Parkut Rekreativ në Lagjen e Re” (Zonën A), e cila ka të përfshirë rikonstruksionin e fushës së sportit, rehabilitimi i zonës përreth fushës së sportit, ndriçimi i fushës së sportit, disiplinimi i ujërave të bardha, ndërtimi i strukturave përforcuese. Në relacionin bashkëlidhur projekt-vendimit nr. 02, datë 19 / 01 /2026 është relatuar vetëm për Zonën A të projektit “Krijimi i Parkut rekreativ në Lagjen e Re” dhe duke marrë parasysh impaktin dhe përfshirjen e grupmoshave të ndryshme në investimet që kryhen nga Bashkia Patos, është e nevojshme që të zbatohet projekti edhe për zonën B. Kjo zonë është projektuar për krijimin e hapësirave të gjelbëruara, shplodhëse dhe argëtuese që do të shërbejnë për të gjithë banorët e lagjes.

Vlera totale e projekti është 41,146,479.42 (dyzet e një milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë dyzet e dy) lekë me tvsh (përfshihet vlera e mbikqyrjes dhe kolaudimit në total për të gjithë projektin).

Financimi i këtij objekti do të mbulohet brenda shpenzimeve kapitale të miratuara në në programin “Arsimi, Kultura, Sporti dhe Çështjet Sociale” midis vlerës së projekteve të miratuara për vitin 2026-2028 nga objektin “Rikonstruksioni i kopshtit nr.2” në vlerën 5,000,000 lekë për vitin 2027 dhe nga objekti “Rikonstruksioni i Pallatit të Kulturës” në vlerën 20,110,419.42 lekë për vitin 2028.

I KËRKOJMË KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS:

- Të miratojë saktësimin e emërimit përfundimtar të projektit “Krijimi i parkut rekreativ në lagjen e Re.
- Të miratojë ndryshimin e shkronjës b, pika 2, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 04, datë 30.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026” duke transferuar fondin prej 3,681,835 lekë nga objekti “*Studim, projektim dhe hartim i PDV-ve*”, në objektin “*Rikonstruksioni i rrugës Manxharaj, Gjy노qarë*”, brenda programit “Zhvillimi Ekonomik dhe Rural”.

Për ndjekjen dhe zbatimin ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës dhe Sportit, Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile dhe Njësia e Prokurimit.


Drejtuesi i Programit
Zhvillimi Ekonomik dhe Rural
Boreta Murati



**Dr. Mbrojtjes sociale, Arsimit
Kulturës dhe Sportit**
Mitjon Nikolla



Dr. Finance
Mimoza Shtëmbari



Zv/Kryetar
Ina Sauli

Juristi

Joana Sherifi

